



**Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës**  
Republika Kosova- Opstine Suvareka  
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Procesverbali nga Dëgjimi Publik me banorët e fshatit Duhël, Greiqec  
për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Dëgjimi buxhetor me banoret e fshatrave Duhël, Greiqec u mbajtë më: 20.05.2026 në SHFMU “Sadri Duhla” në Duhël, Komuna Suharekë, me fillim në ora 18:00.

Dëgjimin e shpalli të hapur Kryetari i fshatit Duhël, z.Lirim Qatani, i cili përshëndeti pjesmarrësit, qytetarët dhe stafin Komunal të përbërë nga : Amir Hoxhën- Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Kymete Bajraktarin-Drejtoreshën për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe Florinda Isufaj-Zyrtare Ligjore në DSHPE.

**Kymete Bajraktari-** Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përshëndeti dhe falenderoi pjesmarrësit, duke filluar prezantimin e Planifikimit Buxhetore për vitin 2027-2029. Ajo theksoi se ky takim është organizuar për të ndëgjuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për shqyrtim të mëtejme

**Amir Hoxha -** Amir Hoxhën- Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, përshëndeti dhe falenderon pjesmarrësit, prezantoi investimet kapitale të planifikuara për vitin 2026, si dhe i njofton banorët që sipas kërkesave të kryesisë së fshatit në bashkëpunim me përfqesuesit e lagjeve procedura e inicimit për rregullimin e rrugëve në fshatin Duhël për vitin 2026 i është dorëzuar Zyrës së Prokurimit.

**Hamdi Rrafshi-** Parashtrori dy kërkesa: Të bëhet zhblokimi tek nën kalimi në rrugën kryesore pasi që dalja e gypit është i bllokuar, si dhe kërkon të vendosen rrethojat e shkollës, dhe të bëhet rregullimi i oborrit të shkollës, pasi që shkolla nuk ka mjete financiare.

**Shpend Bujari-** Trotuari i rrugës në Lagjen Bujari është i dëmtuar, si dhe trotuari i rrugës kryesore ‘Shotë Galica’ duhet të ndërtohet pasi që paraqet rrezik për nxënësit dhe të gjithë banorët. Kanalizimi është i bllokuar tek Lagja Bujari në një pikë.

**Shqiprim Qatani-** Shtrirja e rrjetit të ndriqimit publik tek Lagja Graishta dhe Lagja Sopa.

**Lirim Qatani-**Kryetari i fshatit-kërkon që komuna në bashkëpunim me Hidroregjionin Jugor-Njësia në Suharekë të bëjnë shtrirjen e rrjetit të ujësjellsit, pasi që fshati Duhël fare nuk ka rrjet të ujsjellsit. Së pari të bëhet sigurimi i burimit të ujit dhe të fillohet pastaj me shtrirjen e rrjetit të ujsjellsit në fshat. Shkolla e fshatit furnizohet me ujë nga pusi, ndërsa Ambullanta furnizohet nga një biznes afër.

**Enver Qatani-** në Rrugën “Sherif Qatani” nuk ka trotuar, duhet së paku të bëhet sinjalizimi, pasi që mungesa e trotuarit paraqet rrezik të madh për këmbësorët.

**Lirim Qatani-**Falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm ndër vite me organet komunale.

Takimi përfundoi në orën : 18:40

Procesmbajtëse : Florinda Isufaj



Lista e pjesëmarrësve në dëgjime publike në DUHËL

Data: 20.05.2026

Nr	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi	Nr.tel
1	Hamdi Krafshi	Duhël		044 187 070
2	Naser Bujori	DUHËL		049 861104
3	ASMIR BUJARI	DUHËL		049 119-083
4	SHPEMO BUJARI	DUHËL		049 113 138
5	Edon Bujari	DUHËL		049 169-153
6	Enver Përkeshi	Duhel		
7	SHQIPRIM QATANI	DUHËL		049-195-845
8	Shqiprim QATANI	Duhël		044 717 866
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				